

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“New Fragen by Intermedica” Shpk

Ortakët themelues:

1. **Shoqëria “Intermedica Center” shpk** themeluar me datë 21/05/1996 dhe regjistruar me date 06/03/2003 me numër Nipt K31513084W me adresë kryesore : Njesia administrative nr 9, Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale nr 8330, Nr Pasurie 8/416-N9, 8/416-N7, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Thoma Vasili me numër Karte Identiteti J11124074J, banues në Tiranë

2. **Z.Gert Reka** lindur dhe banues në Durrës me numër Karte Identiteti I50310072W.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 26.07.2022 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “*New Fragen by Intermedica*” shpk

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “*New Fragen by Intermedica*” shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “*New Fragen by Intermedica*” shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Lagjia nr 5, Rruga Dalip Tabaku, Objekti me numer pasurie 7/231-N2, Zona Kadastrale 8513, Durrës.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë


4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e shërbime të analizave mikrobiologjike, kimike, hormonale, bakterologjike, molekulare dhe gjenetike.

Ushtrimi aktivitetit diagnostikues dhe kurues, kurimi semundjeve në kushte ambulatorore, organizim të shërbimit të urgjencës. Organizon trajnime profesionale për llogari të vet dhe / ose për llogari të treta.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “*New Fragen by Intermedica*” shpk do të jetë me afat të pacaktuar.



NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “*New Fragen by Intermedica*” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “*New Fragen by Intermedica*” Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “*New Fragen by Intermedica*” Shpk është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1-“Intermedica Center” shpk me Nipt K31513084W është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 45 % të kapitalit të shoqërisë.

2- Zt Gert Reka është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 55% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 3(tre)vjet. Kompetencat e adminsitrorit përcaktohen në statutin e shoqërisë. Administrator i Shoqërisë është zt.Gert Reka lindur në Durrës dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër I50310072W.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

“*New Fragen by Intermedica*” Shpk



“Intermedica Center”shpk

Administratori

Thoma Vasili

Thoma Vasili

Th. Vasili



Gert Reka

GERT Reka
G